# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare**

**www.legjislacioni.gov.al**

**Nr. 134** **Datë 22 gusht 2014**


PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 102/2014<br>datë 31.7.2014 | Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë............................... | 6081 |

**LIGJ**
**Nr. 102/2014**

**KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË[1]**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME, ORGANIZIMI DHE KOMPETENCAT E ADMINISTRATËS DOGANORE

KREU I
FUSHA E ZBATIMIT, MISIONI DHE PËRKUFIZIME

Neni 1
**Objekti dhe fusha e zbatimit**

Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, në vijim Kodi, vendos rregullat dhe procedurat e përgjithshme të zbatueshme për mallrat që hyjnë në/ose që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, si dhe statusin, kompetencat e organizimin e personelit të administratës doganore.

Kodi zbatohet në mënyrë uniforme në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë pa cenuar marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 2
**Misioni i autoriteteve doganore**

1. Autoritetet doganore kanë si përgjegjësi kryesore mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në tregti dhe në sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar. Autoritetet doganore duhet të marrin masat, me anë të të cilave synohet, në veçanti:

a) mbrojtja e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit;

b) garantimi i sigurisë e i mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe i banorëve të saj, si dhe mbrojtjes së mjedisit e, kur është e nevojshme, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera;

c) mbajtja e balancës së duhur ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë së ligjshme.

2. Autoritetet doganore, në bashkëpunim me organizmat e tjerë publikë, kanë si objektiv kryesor garantimin e interesave fiskalë, të sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, duke qenë të pajisur me mjetet që i lejojnë të reagojnë në rast krizash dhe t'u përgjigjen kërkesave të reja në fushën e politikës me interes të përgjithshëm.

3. Doganat shqiptare, për realizimin e këtij qëllimi, përcaktojnë parimet strategjikë si më poshtë:

a) Parimi i mbrojtjes së shoqërisë dhe interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë përmes:

i) sigurimit të mbledhjes korrekte dhe të efektshme të detyrimeve e të taksave;

ii) aplikimit të masave efektive për ndalimin e lëvizjes së mallrave të paligjshme, të falsifikuara e pirate, të kufizuara e të ndaluara;

iii) zhvillimit të mëtejshëm të një analize risku të efektshme për të kontribuar në luftën kundër terrorizmit e kriminalitetit dhe, në veçanti, për tregtinë e drogave, mallrave të falsifikuara e pirate;

iv) parandalimit, zbulimit, hetimit dhe procedimit për mashtrimet dhe shkeljet e legjislacionit doganor;

v) përdorimit të asistencës administrative dypalëshe për të siguruar mirëfunksionimin e legjislacionit doganor.

b) Parimi i mbështetjes së konkurrueshmërinë së kompanive shqiptare përmes:

i) modernizimit të ambientit dhe të metodave të punës së doganës (në veçanti me përafrimin e sistemeve ose me anë të forcimit dhe harmonizimit të metodave të punës);

ii) aplikimit të një mjedisi doganor pa letër (dogana elektronike);

iii) qasjes proaktive drejt standardeve, përmes miratimit të standardeve ndërkombëtare, siç janë ato të zhvilluara nga Organizata Botërore e Doganave dhe Bashkimi Europian.

c) Parimi i lehtësimit të mëtejshëm të tregtisë së ligjshme përmes:

i) ndërtimit dhe përmirësimit të sistemeve të kontrollit, të cilat reduktojnë ndërhyrjet në trafikun e mallrave, si dhe barrierat administrative në minimumin e nevojshëm, me qëllim që të arrihen objektivat e tjerë të politikës së përgjithshme, siç janë kërkesat në fushën e sigurisë;

ii) krijimit të lehtësive për operatorët ekonomikë të ligjshëm, me qëllim reduktimin e kostove.

ç) Parimi i kontrollit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit të përdorur për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave përmes:

[1] *Rregullorja e Parlamentit Europian dhe Këshillit (BE) nr. 952/2013, datë 9 tetor 2013, "Mbi përcaktimin e Kodit Doganor të Bashkimit Europian", numri CELEX: 32013R0952, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 269, datë 10.10.2013, faqe 1-101.*

i) përmirësimit dhe forcimit të efektshmërisë së kontrolleve në vendndodhjet optimale të tyre (në kufi ose brenda territorit) në zinxhirin e furnizimit;

ii) zbatimit korrekt dhe të qëndrueshëm të legjislacionit, lidhur me kontrollin dhe lëvizjen e mallrave;

iii) bërjes më të efektshme dhe sistematike të përdorimit të përbashkët të informacioneve për risqet;

iv) marrjes në konsideratë të mundësive për të ndarë informacionin me partnerët kryesorë tregtarë, me qëllim menaxhimin dhe kontrollin e gjithë zinxhirit të furnizimit.

d) Parimi i bashkëpunimit, duke mbajtur, zhvilluar dhe shtuar marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve doganore dhe agjencive të tjera qeveritare dhe ndërmjet autoriteteve doganore dhe komunitetit të biznesit përmes:

i) thellimit të bashkëpunimit ekzistues;

ii) koordinimit të aksioneve në mbrojtje të interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë;

iii) marrjes së rolit drejtues në zhvillimin e mekanizmave për bashkërendimin e punës me agjencitë e tjera që veprojnë në kufi (një sportel);

iv) përmirësimit të mekanizmave të konsultimit dhe bashkëpunimit me biznesin;

v) përforcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar ose asistencës së ndërsjellë në fushën e doganave nëpërmjet marrëveshjeve me vendet e tjera dhe shtrirjes së pjesëmarrjes në forumet ndërkombëtare përgjegjëse për ligjet dhe vendimet ndërkombëtare, të tilla si embargo, marrëveshjet për ambientin, marrëveshjet për mbrojtjen e pronësisë intelektuale etj.

Neni 3
**Territori doganor**

Territori doganor përfshin territorin tokësor, ujërat territoriale, ujërat e brendshme dhe hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
**Zona dhe vija doganore**

1. Zona doganore përfshin atë pjesë të territorit doganor ku veprojnë autoritetet doganore, si dhe të gjitha zonat ku këto autoritete ushtrojnë kontroll ose mbikëqyrje doganore.

2. Zonat doganore vendosen në pikat e kontrollit të kalimit të kufirit, si dhe në pika të tjera të territorit doganor.

3. Krijimi, shtrirja territoriale dhe klasifikimi i zonave doganore të përhershme ose të përkohshme përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave, sipas kërkesës së motivuar të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, bazuar në rritjen e numrit të operatorëve ekonomikë që operojnë në atë territor dhe pamundësisë së zonës doganore ekzistuese për kryerjen e procedurave doganore.

4. Vija doganore është bregdeti, brigjet e liqeneve e të lumenjve kufitarë dhe kufijtë tokësorë me shtetet e tjera.

5. Mallrat duhet të kalojnë vijën doganore të kufirit tokësor, ujor dhe në aeroporte vetëm në pikat e kalimit të kufirit shtetëror ku ka zona doganore.

Neni 5
**Shtrirja e zonës doganore**

1. Zona doganore e mbikëqyrjes tokësore përbëhet nga territori që përfshin hapësirën nga vija doganore e kufirit tokësor deri në 10 km në brendësi. Përgjatë bregdetit kjo zonë mbikëqyrjeje shkon deri në 5 km nga bregu në brendësi.

2. Zona doganore e mbikëqyrjes ujore përbëhet nga rripi i ujit që shtrihet prej vijës doganore deri në kufirin e jashtëm të ujërave territoriale dhe të ujërave të brendshme.

Neni 6
**Përkufizime**

Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Autoritete doganore" është administrata doganore e Republikës së Shqipërisë, përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit doganor, dhe çdo autoritet tjetër i ngarkuar me ligj për të zbatuar dispozita të veçanta të legjislacionit doganor.

2. "Legjislacion doganor" është kuadri ligjor, i përbërë nga:

a) konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

b) Kodi Doganor;

c) legjislacioni për tarifën doganore dhe nomenklaturën e kombinuar të mallrave, në Republikës së Shqipërisë;

ç) aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

3. "Kontrolle doganore" janë veprime të veçanta, të kryera nga autoritetet doganore për të garantuar zbatimin e saktë të legjislacionit doganor dhe çdo legjislacioni tjetër që ka të bëjë me hyrjen, daljen, transitin, lëvizjen, magazinimin dhe përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use) të mallrave që lëvizin ndërmjet territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe territoreve të tjera dhe prezenca e lëvizja brenda territorit doganor të mallrave joshqiptare dhe mallrave që i nënshtrohen procedurës së përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use).

4. "Person" është një person fizik, një person juridik, si dhe çdo person tjetër/individ me zotësi të plotë për të vepruar, të njohur si subjekte nga legjislacioni në fuqi.

5. "Operator ekonomik" është personi, i cili, gjatë aktivitetit të tij tregtar, përfshihet në veprime të mbuluara nga legjislacioni doganor.

6. "Përfaqësues doganor" është çdo person i caktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga një person tjetër, për të kryer veprimet dhe formalitetet e kërkuara nga legjislacioni doganor në marrëdhëniet e tij me autoritetet doganore.

7. "Risk" është mundësia dhe ndikimi i një ngjarjeje që mund të ndodhë në lidhje me hyrjen, daljen, transitin, lëvizjen, përpunimin ose përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use) të mallrave, që lëvizin ndërmjet territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve apo territoreve jashtë këtij territori dhe të prezencës së mallrave joshqiptare brenda territorit doganor, të cilat mund të sjellin një nga rezultatet e mëposhtme:

a) pengimin e zbatimit të saktë të masave kombëtare;

b) komprometimin e interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë;

c) paraqitjen e një kërcënimi për mbrojtjen dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë dhe banorëve të saj, për qeniet njerëzore, për florën dhe faunën, për mjedisin ose për konsumatorët.

8. "Formalitete doganore" janë të gjitha veprimet që duhet të kryhen nga personat dhe nga autoritetet doganore, me qëllim zbatimin e legjislacionit doganor.

9. "Deklaratë përmbledhëse e hyrjes" është akti, me anë të të cilit një person informon autoritetet doganore, sipas mënyrës dhe formës së parashikuar, brenda një afati kohor të caktuar, që mallrat do të hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

10. "Deklaratë përmbledhëse e daljes" është akti, me anë të të cilit një person informon autoritetet doganore, sipas mënyrës dhe formës së parashikuar, brenda një afati kohor të caktuar, që mallrat do të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

11. "Deklaratë e magazinimit të përkohshëm" është akti, me anë të të cilit një person shpreh, sipas mënyrës dhe formës së parashikuar, që mallrat janë në magazinim të përkohshëm.

12. "Deklaratë doganore" është akti, me anë të të cilit një person shpreh, në formën dhe mënyrën e parashikuar, vullnetin për të vendosur mallrat nën një regjim doganor të caktuar, ku të tregohet, nëse është rasti, regjimi specifik për t'u zbatuar.

13. "Deklaratë rieksporti" është akti, me anë të të cilit një person shpreh, në formën dhe mënyrën e parashikuar, vullnetin për të nxjerrë mallrat joshqiptare, me përjashtim të atyre nën një regjim zone të lirë ose magazinimi të përkohshëm, jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

14. "Njoftim rieksporti" është akti, me anë të të cilit një person shpreh, në formën dhe mënyrën e parashikuar, vullnetin për të nxjerrë mallrat joshqiptare, që janë nën një regjim zone të lirë ose magazinimi të përkohshëm, jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

15. "Deklarues" është personi që depoziton një deklaratë doganore, deklaratë për magazinim të përkohshëm, një deklaratë përmbledhëse në hyrje, një deklaratë përmbledhëse të daljes, një deklaratë rieksporti ose një njoftim rieksporti në emër të saj/të tij ose personit, në emër të të cilit është bërë një deklarim ose njoftim i tillë.

16. "Regjim doganor" është një nga regjimet e mëposhtme, nën të cilat mallrat vendosen në përputhje me këtë Kod:

a) çlirimi për qarkullim të lirë;

b) regjime të posaçme;

c) eksporti.

17. "Magazinim i përkohshëm" është situata e mallrave joshqiptare të magazinuara përkohësisht nën mbikëqyrjen doganore në periudhën ndërmjet paraqitjes së tyre në doganë dhe vendosjes së tyre në një regjim doganor ose rieksporti.

18. "Borxh doganor" është detyrimi i një personi për të paguar shumën e detyrimit të importit ose shumën e detyrimit të eksportit, të cilat zbatohen për mallra të caktuara, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

19. "Debitor" është çdo person që ka një borxh doganor për të paguar.

20. "Detyrim importi" është detyrimi doganor që duhet paguar në importimin e mallrave.

21. "Detyrim eksporti" është detyrimi doganor që duhet paguar në eksportimin e mallrave.

22. "Status doganor" është statusi i mallrave si mallra shqiptare ose joshqiptare.

23. "Mallra shqiptare" janë mallrat e një prej kategorive të mëposhtme:

a) mallrat tërësisht të përftuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që nuk kanë në përbërje mallra të importuara nga vende ose territore të tjera;

b) mallrat që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga vende ose territore jashtë këtij territori dhe të çliruara për qarkullim të lirë;

c) mallrat e përftuara ose të prodhuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë vetëm nga mallrat që përmenden në shkronjën "b" ose nga mallrat që përmenden në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike.

24. "Mallra joshqiptare" janë të gjitha mallrat e tjera që nuk përmenden në pikën 23, ose ato që kanë humbur statusin e tyre doganor si mallra shqiptare.

25. "Menaxhim i riskut" është identifikimi sistematik i riskut, përfshirë edhe kontrollet e rastësishme dhe zbatimi i të gjitha masave të nevojshme për kufizimin e ekspozimit ndaj riskut.

26. "Çlirim i mallrave" është akti, me anë të të cilit autoritetet doganore i bëjnë mallrat të disponueshme për qëllimet e parashikuara nga regjimet doganore, në të cilat janë vendosur.

27. "Mbikëqyrje doganore" është veprimi i ndërmarrë në përgjithësi nga autoritetet doganore për të siguruar respektimin e legjislacionit doganor dhe, kur është e nevojshme, të dispozitave të tjera të zbatueshme mbi mallrat që i nënshtrohen këtij veprimi.

28. "Rimbursim" është kthimi i një shume detyrimi importi ose eksporti që është paguar.

29. "Falje" është heqja dorë nga detyrimi për të paguar një shumë detyrimi importi apo eksporti që nuk është paguar.

30. "Produkte të përpunuara" janë mallrat e vendosura në një regjim përpunimi dhe që u janë nënshtruar operacioneve përpunuese.

31. "Person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë" është:

a) në rastin e një personi (individ), çdo person që ka vendqëndrimin, (vendbanimin) në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) në rastin e një personi fizik ose juridik, i njohur si i tillë nga legjislacioni në fuqi, çdo person që ka selinë, zyrën qendrore, degën apo vendodhjen e përhershme të biznesit, të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

32. "Vendndodhje e përhershme biznesi" është zyra qendrore ose dega e biznesit, ku janë gjithmonë burimet e nevojshme njerëzore dhe ato teknike, nëpërmjet të cilave kryhen pjesërisht ose tërësisht operacionet e një personi që ka marrëdhënie me doganën.

33. "Paraqitje e mallrave në doganë" është njoftimi i autoriteteve doganore për mbërritjen e mallrave në zyrën doganore ose në çdo vend tjetër, të përcaktuar ose të miratuar prej autoriteteve doganore, dhe bërja e disponueshme e këtyre mallrave për kontrolle doganore.

34. "Mbajtës i mallrave" është personi, i cili është pronari i mallrave ose personi, i cili ka të drejta të ngjashme disponimi mbi këto mallra ose që ka zotërim fizik mbi to.

35. "Mbajtës i regjimit" është:

a) personi që depoziton deklaratën doganore ose personi, për llogari të të cilit depozitohet një deklaratë doganore; ose

b) personi, të cilit i janë transferuar të drejtat dhe detyrimet lidhur me një regjim doganor.

36. "Masa të politikës tregtare" janë masat jotarifore të miratuara, si pjesë e politikave tregtare, që rregullojnë tregtinë ndërkombëtare të mallrave.

37. "Operacion përpunimi" është një nga operacionet e mëposhtme:

a) punimi i mallrave, përfshirë montimin ose bashkimin apo përshtatjen e tyre me mallra të tjera;

b) përpunimi i mallrave;

c) shkatërrimi i mallrave;

ç) riparimi i mallrave, përfshirë ndreqjen dhe rregullimin e tyre;

d) përdorimi i mallrave, të cilat nuk gjenden në produktet e përpunuara, por që lejojnë ose lehtësojnë prodhimin e këtyre produkteve edhe sikur ato të jenë përdorur tërësisht ose pjesërisht në proces (aksesorët e prodhimit).

38. "Koeficient i shfrytëzimit" është sasia ose përqindja e produkteve të përpunuara që përftohen nga përpunimi i një sasie të caktuar mallrash, të vendosura nën një regjim përpunimi.

39. "Zyrë doganore" është çdo zyrë, në të cilën mund të kryhen të gjitha ose një pjesë e formaliteteve që parashikon legjislacioni doganor.

40. "Vendim" është çdo akt zyrtar i lëshuar nga autoritetet doganore, në zbatim të legjislacionit doganor, që rregullon një çështje të veçantë dhe ka efekte dhe/ose pasoja ligjore mbi personin ose personat përkatës.

41. "Transportues" është:

a) në kuptim të hyrjes, personi i cili sjell mallrat ose që merr përgjegjësinë për transportin e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Sidoqoftë:

i) në rastin e transportit të kombinuar, "transportues" është personi që operon mjetet e transportit, të cilat, mbasi kanë hyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, lëvizin vetë si një mjet aktiv transporti;

ii) në rastin e transportit ajror apo detar me një mjet të përbashkët transporti apo të një marrëveshjeje kontraktuale, "transportues" është personi, i cili lidh një kontratë dhe lëshon një dokument transporti detar ose ajror (bill of lading ose air waybill) për transportin konkret të mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) në kuptim të daljes, personi, i cili nxjerr mallrat ose që merr përgjegjësinë për transportin e mallrave jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Sidoqoftë:

i) në rastin e transportit të kombinuar, kur mjeti aktiv i transportit që lë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë është vetëm duke transportuar një mjet tjetër transporti, i cili, mbas mbërritjes së mjetit aktiv të transportit në destinacion, do të lëvizë vetë si një mjet aktiv transporti, "transportues" është personi që do të operojë mjetin e transportit që do të lëvizë vetë sapo mjeti i transportit, që lë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ka arritur në destinacionin e tij;

ii) në rastin e transportit ajror apo detar me një mjet të përbashkët transporti apo të një marrëveshjeje kontraktuale, "transportues" është personi, i cili lidh një kontratë dhe lëshon një dokument transporti detar ose ajror (bill of lading ose air waybill) për transportin konkret të mallrave që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

42. "Komision blerjeje" është një tarifë e paguar nga një importues te një agjent për ta përfaqësuar atë në porositjen e mallrave që vlerësohen.

43. "Garancia globale" është garancia që mbulon shumën e detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon borxhit doganor, në lidhje me dy ose më shumë operacione, deklarata dhe regjime doganore.

## KREU II
## ORGANIZIMI I ADMINISTRATËS DOGANORE DHE I VEPRIMTARISË DOGANORE, KOMPETENCAT, BASHKËPUNIMI, PUNËSIMI DHE MARRËDHËNIET E PUNËS SË PERSONELIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE

### SEKSIONI 1
### ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS DOGANORE QENDRORE DHE VENDORE

#### Neni 7
#### Organizimi dhe funksionimi i administratës doganore

1. Administrata doganore përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët doganore. Ajo është nën varësinë e Ministrisë së Financave.

2. Degët doganore janë nën varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Ato përbëhen nga një ose disa zyra doganore.

3. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e administratës doganore përcaktohen në këtë Kod, në ligje specifike dhe me vendim të Këshillit të Ministrave, të dala në zbatim të tyre.

4. Personeli doganor i strukturave hetimore, luftës kundër kontrabandës dhe trafikut të paligjshëm dhe i strukturave të tjera doganore, që përcaktohen me ligj specifik, kanë atributet e Policisë Gjyqësore. Të drejtat dhe detyrat e personelit në kryerjen e funksioneve të Policisë Gjyqësore janë të përcaktuara nga legjislacioni specifik për këtë qëllim.

#### Neni 8
#### Struktura e administratës doganore

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave dhe në bashkërendim me Departamentin e Administratës Publike, miraton me vendim, strukturën organizative dhe organikën e personelit të administratës doganore, në mënyrë që të garantojë mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë dhe një organizim të përshtatshëm për dinamizmin dhe veçantinë e veprimtarisë doganore.

#### Neni 9
#### Orari i funksionimit

1. Në parim orari i funksionimit të zyrave doganore është 24 orë. Megjithatë, për raste të tjera ky orar vendoset ndryshe, në mënyrë që të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm, duke marrë në konsideratë llojin e trafikut/transportit të mallrave, si dhe regjimet doganore, në të cilat ato do të vendosen, me qëllim që të mos pengohet dhe të mos vështirësohet trafiku ndërkombëtar i mallrave.

2. Kur është e mundur, për zyrat doganore që operojnë në kufi, orari i funksionimit vendoset në bashkëpunim me administratat doganore homologe.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për përcaktimin e orarit të funksionimit të zyrave të administratës doganore, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni.

### SEKSIONI 2
### KOMPETENCAT E AUTORITETEVE DOGANORE DHE BASHKËPUNIMI

#### Neni 10
#### Kompetencat e autoriteteve doganore

Autoritetet doganore kanë kompetencat si më poshtë:

1. Ngarkimi, shkarkimi, imbarkimi, zbarkimi dhe transbordimi i mallrave dhe mjeteve përgjatë vijës doganore kufitare dhe në aeroporte kryhen me lejen e autoriteteve doganore dhe në përputhje me mënyrat e përcaktuara prej tyre.

2. Autoritetet doganore janë përgjegjëse për:

a) kryerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuara në këtë Kod, në ligje të tjera specifike dhe në akte nënligjore për mallrat në hyrje, në dalje dhe brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) verifikimin dhe vjeljen e detyrimeve që duhen paguar, si dhe të sanksioneve përkatëse;

c) parandalimin, zbulimin, hetimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë kontrabandë, shkeljeve, trafikut të paligjshëm të mallrave të ndaluara ose të kufizuara, cenimit të të drejtave të pronësisë intelektuale etj.;

ç) konstatimin, verifikimin dhe sanksionimin e shkeljeve të parashikuara në këtë Kod, në aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe në ligje të tjera ku administrata doganore është e ngarkuar për zbatim;

d) negocimin, përgatitjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare në fushën e doganave, sipas autorizimit;

dh) mbi bazën e një kërkese me shkrim, dërgimin apo dhënien e të dhënave statistikore për ministritë e linjës dhe për organet e tjera publike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

e) mbikëqyrjen në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave që i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve doganore.

3. Autoritetet doganore, si autoriteti kompetent, mbikëqyrin dhe ushtrojnë kontrolle mbi të gjitha mallrat, mbi mjetet e transportit, bagazhet dhe udhëtarët që kalojnë vijën doganore në zonat doganore e përgjatë vijës kufitare, tokësore e ujore, në ujërat e brendshme dhe në hapësirën ajrore, që janë nën mbikëqyrjen e

autoriteteve doganore. Autoritetet doganore kanë të drejtën edhe të kontrollit trupor të individëve për mallrat që mbajnë ose fshehin në trupin e tyre.

4. Në pikat e kalimit të kufirit tokësor, ujor e në aeroporte, si dhe në dalje nga zyrat e brendshme doganore organizohet kontrolli i mallrave dhe i mjeteve të transportit, që dalin nga zonat doganore, për të verifikuar nëse lloji dhe sasia e mallrave të transportuara janë në përputhje me dokumentet shoqëruese.

Nëse nuk rezultojnë mospërputhje, nëpunësit e doganës që kryejnë këtë shërbim vendosin mbi dokumentet doganore vulën dhe/ose shënimet përkatëse në sistemin elektronik të doganës. Në rast të kundërt, ata përpilojnë procesverbalin përkatës, të cilin ia kalojnë kryetarit të degës doganore për të kryer formalitetet e mëtejshme.

5. Kur është e nevojshme, kontrolli i parashikuar në pikën 4 kryhet nga autoritetet doganore edhe përgjatë rrugëve të lëvizjes së mjeteve të transportit. Në këtë rast, nëpunësit e doganës, që janë ngarkuar për të ndaluar mjetet e transportit, përdorin tabelën e ndalim-qarkullimit, me të cilën janë pajisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe i tregojnë drejtuesit të mjetit kartën e tyre identifikuese. Në rast se nga kontrolli i bërë rezultojnë parregullsi, punonjësit e doganës e shoqërojnë mjetin e transportit pranë zyrës doganore më të afërt, ku përpilojnë procesverbalin përkatës, i cili i dorëzohet kryetarit të degës doganore për të kryer formalitetet e mëtejshme.

6. Autoritetet doganore mund të kryejnë të gjitha kontrollet e nevojshme pranë mjediseve të deklaruesit apo mbajtësit të një autorizimi ose regjimi apo të çdo personi tjetër, që është përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në çlirimin e mallrave, sipas akteve nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Autoritetet doganore mund të kryejnë gjithashtu kontrollin e deklarimit të parave, valutës, letrave me vlerë dhe gurëve të çmuar që hyjnë e dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

7. Përfaqësuesit e autoriteteve doganore mund të sekuestrojnë dokumente, skedarë kompjuterikë ose regjistrat përkatës, si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, tregtar apo fiskal, të ndodhur në ambientet e operatorëve ekonomikë, në rastet e dyshimeve të arsyeshme për kryerjen e ndonjë prej shkeljeve të parashikuara nga ky Kod.

Procedurat specifike dhe të detajuara që duhen ndjekur nga autoritetet doganore në rastet e sekuestrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij Kodi.

8. Në rastet kur autoritetet e tjera që veprojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë kanë dyshime ose vihen në dijeni për shkelje të normave të këtij Kodi, të akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe të ligjeve të tjera, zbatimi i të cilave është detyrë e autoriteteve doganore, ato njoftojnë menjëherë degën doganore që mbulon territorin në fjalë. Kjo e fundit kryen të gjitha verifikimet e formalitetet e rastit, përfshirë këtu edhe njoftimin e organeve gjyqësore, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod.

9. Kur ka dyshime të bazuara për trafik të paligjshëm ose për krime të tjera në fushën e doganave, të parashikuara në Kodin Penal, autoritetet përkatëse të procedimit penal mund të ndalojnë mjetet e transportit që u nënshtrohen formaliteteve doganore dhe që janë të plumbosura prej autoriteteve doganore. Në këto raste, mjetet e transportit shoqërohen në zyrën doganore më të afërt që është territorialisht kompetente, ku hiqet plumbçja. Autoritetet përkatëse të procedimit penal, në bashkëpunim të plotë me autoritetet doganore, kryejnë të gjitha kontrollet që konsiderohen të nevojshme. Këto autoritete, në përfundim të kontrollit përgatisin një raport me shkrim i firmosur nga të dyja palët, i cili, nëse është rasti, i dërgohet prokurorisë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal. Çdo kontroll dhe akt i mbajtur jashtë zyrës doganore është i pavlefshëm.

10. Autoritetet doganore, për të siguruar zbatimin me korrektësi të dispozitave ligjore mund të vendosin plumbçe ose stampa në mjetet e transportit, mallrat, magazinat dhe ambientet e operatorit ekonomik, aparate ose mekanizma, si dhe në vende të tjera, me qëllim mbrojtjen e interesave fiskalë, të sigurisë dhe të mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

11. Autoritetet doganore mbledhin informacion dhe bëjnë hetime për zbatimin korrekt të dispozitave të këtij Kodi. Për këtë qëllim ato mund:

a) të ftojnë, duke dhënë arsyen, çdo person, që merr pjesë në aktivitete të lidhura me procedurat e import-eksportit, që të paraqitet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij për të dhënë informacione, sqarime apo dokumentacion që lidhet me mallrat e importuara ose të eksportuara;

b) t'u kërkojnë shoqërive tregtare, institucioneve të kreditimit, administratës postare ose çdo organizmi publik e privat, ku gjenden informacione të vlefshme për hetimin, që në përputhje me legjislacionin në fuqi të japin informacion ose kopje të dokumentacionit në lidhje me marrëdhënien me klientin;

c) të kërkojnë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kopje ose ekstrakte të akteve dhe dokumenteve që gjykohen të nevojshme për hetimet ose kontrollet, të depozituara në organizma dhe ente publike e private, si dhe në zyrat noteriale;

ç) me pëlqimin e pronarit ose me vendim të lëshuar nga gjykata ose prokurori, të kryejnë kontroll në të gjitha ambientet, të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 6, përfshirë ato private, në çdo orë, në rast të

dyshimeve të bazuara për kryerjen e një vepre penale në fushën e doganave;

d) me pëlqimin e pronarit ose me vendim të lëshuar nga gjykata ose prokurori të kryejnë kontroll në çdo kohë në vendet ku dyshohet se mbahen mallra kontrabandë;

dh) në përputhje me legjislacionin në fuqi, autorizohen të kenë akses në bazat e të dhënave të administratave të tjera, përkatësisht:

i) në bazën e të dhënave të personave që hyjnë dhe dalin në/dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë;

ii) në bazën e të dhënave të deklarimit të kapitaleve dhe llogarive bankare, për efekt hetimi;

iii) në bazën e të dhënave të precedentëve policorë;

iv) në bazën e të dhënave të automjeteve të vjedhura.

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat e dhënies së informacionit dhe aksesit në bazat e të dhënave, referuar në shkronjat "b" dhe "dh", të kësaj pike.

12. Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre autoritetet doganore mund t'u kërkojnë individëve dokumentin personal të identifikimit.

13. Punonjësit doganorë janë në mbrojtje të veçantë nga ligji. Kujtdo personi i ndalohet:

a) t'i fyejë apo t'i keqtrajtojë ata në ushtrimin e funksioneve të tyre;

b) t'u kundërvihet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 11

**Kompetencat për kryerjen e formaliteteve doganore**

1. Përveç rasteve të forcave madhore, plotësisht të dokumentuara dhe me përjashtim të regjimit të transitit dhe rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, formalitetet doganore bëhen në degën doganore kompetente për territorin ku është vendosur operatori ekonomik.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, duke bërë përjashtim nga rregulli i shprehur në pikën 1, kur rrethanat kërkojnë kryerje kontrollesh të veçanta, mund të vendosë që formalitetet doganore për disa kategori mallrash të përqendrohen në një degë doganore, të ndryshme nga dega doganore kompetente për territorin ku është vendosur operatori ekonomik.

3. Për nevoja të tregtisë dhe me aplikim të personit të interesuar, kryetarët e degëve doganore mund të lejojnë që disa nga kontrollet doganore të kryhen në mjediset e deklaruesve ose në vende të tjera të propozuara prej tyre, të cilat konsiderohen të përshtatshme nga autoritetet doganore për kryerjen e të gjitha kontrolleve të nevojshme.

4. Operatorit ekonomik i ngarkohen shpenzimet e këtij shërbimi, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave duke llogaritur kohën e harxhuar për kryerjen e kontrollit, si dhe largësinë e këtyre mjediseve nga zyra doganore.

SEKSIONI 3

STATUSI, ORGANIKA, PUNËSIMI DHE MARRËDHËNIET E PUNËS TË PERSONELIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE

Neni 12

**Parime të përgjithshme**

Administrata doganore shqiptare udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, qëndrueshmërisë në detyrë dhe vazhdimësisë në karrierë, integritetit, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e ligjit.

Neni 13

**Statusi, kategorizimi, të drejtat dhe detyrimet e personelit të administratës doganore**

1. Punonjësit e administratës doganore, me përjashtim të punonjësve administrativë, janë nëpunës civil dhe klasifikohen/kategorizohen sipas ligjit "Për nëpunësin civil".

2. Punonjësit e administratës doganore gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në ligjin "Për nëpunësin civil", me përjashtim të së drejtës së grevës.

3. Përjashtimisht përcaktimeve të ligjit "Për nëpunësin civil", për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, pranimi në detyrë, emërimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, transferimi i përkohshëm, elementë specifikë të procedurës së dhënies së masave disiplinore të personelit të administratës doganore pjesë e shërbimit civil, bëhet sipas parimeve dhe procedurave specifike të këtij Kodi dhe akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij për këtë qëllim.

4. Përcaktimi i punonjësve administrativë jepet në ligjin "Për nëpunësin civil".

Neni 14

**Paga**

Me propozimin e Ministrit të Financave dhe të ministrit përgjegjës për Departamentin e Administratës Publike, Këshilli i Ministrave miraton nivelin e pagës për çdo kategori të personelit doganor dhe për punonjësit administrativë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 15

**Marrëdhëniet e punës, pranimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, transferimi i përkohshëm, pezullimi dhe largimi nga detyra i personelit të administratës doganore**

1. Drejtori i Përgjithshëm emërohet, lirohet, apo shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

2. Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm të Doganave emërohen sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara nga ligji "Për nëpunësin civil" dhe nga aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Pranimi në shërbimin doganor bëhet sipas procedurës dhe kushtëzimeve të mëposhtme:

a) Personeli i administratës doganore, pjesë e shërbimit civil, me përjashtim të personelit të kategorisë së lartë drejtuese dhe personelit administrativ, rekrutohet në administratën doganore e pranohet në shërbimin civil nëpërmjet një konkurrimi, bazuar në parimet e meritokracisë dhe barazisë, sipas përcaktimeve të mëposhtme.

b) Kërkesat e përgjithshme për pranim në administratën doganore aplikohen sipas përcaktimit të ligjit "Për nëpunësin civil".

c) Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, dhe zhvillohet në këto dy faza:

i) verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit;

ii) vlerësimi i kandidatëve.

ç) Verifikimi paraprak kryhet nga njësia e burimeve njerëzore, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i përhershëm i pranimit, i krijuar sipas akteve nënligjore të këtij Kodi.

d) Kandidatët fitues, që marrin mbi 70 për qind të pikëve totale të vlerësimit, renditen nga komiteti i përhershëm i pranimit, sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm.

dh) Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për krijimin, përbërjen dhe veprimtarinë e komitetit të përhershëm të pranimit, si dhe rregullat e hollësishme për procedurën e pranimit dhe vlerësimin e kandidatëve.

4. Emërimi i kandidatëve fitues, të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, bëhet si më poshtë:

a) Kandidatët fitues, duke filluar nga ai me më shumë pikë, kanë të drejtën të emërohen në çdo pozicion të kategorisë/klasës, për të cilin është zhvilluar konkurrimi, si dhe në çdo pozicion tjetër të lirë të të njëjtës kategori/klasë, që krijohet i lirë gjatë kohës së vlefshmërisë së listës.

b) Departamenti i Administratës Publike (DAP) bën emërimin sipas procedurës më lart.

c) Lista e kandidatëve fitues, të paemëruar ende, sipas shkronjës "b", të kësaj pike, është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare nga shpallja e fituesve. Kjo listë administrohet edhe nga DAP-i. Nëse gjatë këtij afati zhvillohet një procedurë tjetër konkurrimi për të njëjtin grup, kandidatët fitues të listave, që nuk janë emëruar ende, rirenditen sipas rezultatit përfundimtar.

ç) Këshilli i Ministrave miraton procedurat e hollësishme, sipas kësaj pike të këtij neni.

5. Lëvizja paralele bëhet sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, atë të ulët apo të mesme drejtuese bëhet së pari nga punonjësit doganorë, të së njëjtës kategori/klasë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele si më poshtë.

b) Mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, sipas pikës 5, të këtij neni, punonjësit doganorë (nëpunës civilë) të së njëjtës kategori, që plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë.

c) Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision i brendshëm, i krijuar për këtë qëllim, nëpërmjet një procedure të bazuar në parimet e parashikuara në nenin 12 të këtij Kodi. Një përfaqësues i DAP-it është anëtar i komisionit të brendshëm.

ç) Në përfundim të vlerësimit, komisioni mund të vendosë:

i) përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm për t'u emëruar në vendin e lirë;

ii) përfundimin e procedurës pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk plotëson kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

d) Në rastet e përfundimit të procedurës pa asnjë të përzgjedhur, sipas përcaktimeve të shkronjave "a"-"ç", të kësaj pike, plotësimi i vendeve të lira bëhet përmes procedurës së ngritjes në detyrë të personelit doganor.

dh) Këshilli i Ministrave miraton:

i) kushtet që duhet të plotësojnë nëpunësit për lëvizjen paralele dhe procedurat e hollësishme të lëvizjes paralele;

ii) rregullat për krijimin dhe përbërjen e komisionit, të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 5, të këtij neni.

6. Ngritja në detyrë e personelit doganor bëhet si më poshtë:

a) Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet procedurës së konkurrimit, organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me DAP-in, për një ose disa pozicione të lira, bazuar në parimin e përmendur në nenin 12, të këtij Kodi.

b) Nëse vendi i lirë i kategorisë së ulët apo të mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas pikës 5, të këtij neni, ai plotësohet nëpërmjet ngritjes në detyrë.

c) Mund të aplikojnë për ngritje në detyrë, fillimisht vetëm nëpunësit civilë brenda administratës doganore, të një kategorie paraardhëse, nëse plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë. Në rast se vendi i lirë nuk plotësohet dot nga punonjësit brenda administratës doganore, si më lart, rihapet procedura për lëvizjen paralele e më pas për ngritjen në detyrë nga nëpunës civilë jashtë administratës doganore.

ç) Nëse vendi i lirë nuk plotësohet as me procedurën më lart, atëherë kalon si vend i lirë, për t'u plotësuar me pranime të reja me konkurrim. Deri në plotësimin përfundimtar të vendit të lirë, nëse është e nevojshme, mund të zbatohet procedura e transferimit të përkohshëm në interes të institucionit.

d) Këshilli i Ministrave miraton kushtet që duhet të plotësojnë nëpunësit për ngritjen në detyrë dhe procedurat e hollësishme të ngritjes në detyrë.

7. Transferimi i përkohshëm bëhet si më poshtë:

a) Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:

i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;

ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;

iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.

b) Transferimi mund të bëhet, në një nga departamentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në degët doganore apo pranë strukturave të tjera ku atashohen, sipas ligjit, punonjës doganorë.

c) Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte i transferuar.

ç) Në raste të justifikuara, për shkak të veçorive të veprimtarisë doganore, punonjësi doganor mund të transferohet përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të një kategorie më të lartë, për një periudhë deri në 6 muaj. Gjatë kësaj periudhe punonjësi përfiton të drejtat, pagën dhe privilegjet e tjera të pozicionit të ri të punës.

d) Gjatë periudhës së transferimit, nëse është e zbatueshme, nëpunësi përfiton shtesën për kushtet e punës të pozicionit, në të cilin është transferuar.

dh) Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për transferimin e përkohshëm, sipas kësaj pike.

8. Periudha e provës, transferimi i përhershëm, transferimi në rastin e ristrukturimit të institucionit, transferimi për arsye të paaftësisë shëndetësore dhe shmangies së konfliktit të interesave, pezullimi i marrëdhënies së punës dhe efektet e pezullimit rregullohen sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil.

9. Elementet specifike të procedurës së dhënies së masave disiplinore për punonjësit doganor, procedura e shqyrtimit dhe dhënies së masës, përbërja e komisionit disiplinor rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Për çdo element tjetër të marrëdhënies juridike të punës të punonjësve të administratës doganore me status të nëpunësit civil, më lart përshkruar, që nuk gjen rregullim specifik nga ky Kod apo aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji i nëpunësit civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

11. Punonjësit administrativë punësohen sipas procedurave konkurruese me kontratë pune nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, sipas dispozitave të Kodit të Punës dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

12. Në varësi të organizimit të administratës doganore, detyrat dhe funksionet e secilës prej strukturave të administratës doganore, si dhe kategorive respektive të punonjësve doganorë përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 16

**Etika dhe pajisja me armë**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave përcakton kategoritë e personelit doganor që mbajnë uniformën e shërbimit dhe kategoritë e personelit doganor që mund të pajisen me armë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim. Në rastet kur, për nevoja të shërbimit, është e nevojshme të veprohet pa uniformë, personeli doganor duhet të paraqesë dokumentin e identifikimit, të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

2. Pajisja me armë dhe përdorimi i tyre nga punonjësit e doganës bëhen në përputhje me dispozitat e ligjit për armët dhe të ligjit për përdorimin e armëve të zjarrit.

3. Personeli doganor duhet të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në shërbim, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

4. Personeli doganor është i detyruar të ruajë sekretin profesional dhe konfidencialitetin për të gjitha veprimtaritë që lidhen me ushtrimin e detyrës.

5. Autoritetet doganore, në ushtrimin e funksioneve e të detyrave të tyre, udhëhiqen nga parimi i zbatimit të njëjtë dhe uniform të ligjit.

6. Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, miraton Kodin e Etikës për nëpunësit doganorë dhe rregulloren e mbajtjes së uniformës.

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PERSONAVE SIPAS LEGJISLACIONIT DOGANOR

SEKSIONI 1

KOMUNIKIMI I INFORMACIONEVE

Neni 17

**Mjetet për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit dhe kërkesat e përbashkëta për të dhënat**

1. Të gjitha shkëmbimet e informacioneve, si deklaratat, aplikimet ose vendimet ndërmjet autoriteteve doganore dhe ndërmjet operatorëve ekonomikë e autoriteteve doganore dhe ruajtja e këtyre informacioneve,

siç kërkohet në zbatim të legjislacionit doganor, bëhen duke përdorur teknika informatike të përpunimit të të dhënave.

2. Për qëllime të shkëmbimit dhe ruajtjes së informacionit, në zbatim të pikës 1, hartohen kërkesat e përbashkëta për të dhënat.

3. Përveç teknikës informatike të përpunimit të të dhënave, të parashikuara në pikën 1, mund të përdoren mënyra të tjera të shkëmbimit dhe ruajtjes së informacionit si më poshtë:

a) në mënyrë të përhershme, në raste të justifikuara nga lloji i lëvizjes së mallrave ose kur përdorimi i teknikave informatike të përpunimit të të dhënave nuk janë të përshtatshme për formalitetet doganore në fjalë;

b) në mënyrë të përkohshme, në rast të defekteve të përkohshme të sistemeve informatike të autoriteteve doganore ose të operatorëve ekonomikë.

Neni 18

**Aktet nënligjore**

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kërkesat e përbashkëta për të dhëna, sipas pikës 2, të nenit 17, duke marrë në konsiderate nevojat për të përmbushur formalitetet doganore të përcaktuara në legjislacionin doganor si dhe natyrën e qëllimin e shkëmbimit e të ruajtjes së informacionit, sipas pikës 1, të nenit 17;

b) rastet specifike të përdorimit të mënyrave të tjera të shkëmbimit dhe ruajtjes së informacionit, të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave që mund të përdoren në përputhje me shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 17;

c) lloji i informacionit dhe të dhënat që duhet të përmbajnë regjistrimet e përmendura në pikën 4, të nenit 138, dhe në pikën 1, të nenit 194;

ç) kur është e nevojshme, formati dhe kodi i kërkesave të përbashkëta për të dhënat e përmendura në pikën 2, të nenit 17;

d) rregullat e procedurës për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat mund të bëhen me mënyra të tjera nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave, të përmendura në pikën 3, të nenit 17.

Neni 19

**Regjistrimi**

1. Operatorët ekonomikë, të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë regjistrohen nga autoritetet doganore.

2. Detyrimi i përcaktuar në pikën 1 mund të shtrihet, në raste të veçanta, edhe për operatorë ekonomikë që nuk janë të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Personave të ndryshëm nga operatorët ekonomikë nuk u kërkohet të regjistrohen pranë autoriteteve doganore, përveçse kur parashikohet ndryshe.

4. Rregullat dhe procedurat e regjistrimit të operatorëve ekonomikë, të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, si dhe rregullat për çregjistrimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

**Komunikimi i informacioneve dhe mbrojtja e të dhënave**

1. Çdo informacion i marrë nga autoritetet doganore gjatë kryerjes së detyrave të tyre, i cili është i një natyre konfidenciale ose që është marrë në mënyrë konfidenciale, mbulohet nga kushti i sekretit profesional. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2, të nenit 48, ky informacion nuk jepet nga autoritetet kompetente doganore, pa lejen e shprehur të personit ose autoritetit që e ka dhënë atë.

Megjithatë ky informacion mund të jepet pa leje, kur autoritetet doganore janë të detyruara ose të autorizuara ta bëjnë këtë në përputhje me dispozitat në fuqi, veçanërisht me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave ose kur ka lidhje me procedimet gjyqësore.

2. Informacioni konfidencial, i përmendur në pikën 1, mund t'u komunikohet autoriteteve doganore dhe autoriteteve të tjera kompetente të vendeve apo territoreve jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, për qëllime të bashkëpunimit doganor me ato vende apo territore, bazuar në një marrëveshje ndërkombëtare ose në legjislacionin kombëtar në fushën e tregtisë.

3. Çdo dhënie ose komunikim i informacionit, të përmendur në pikat 1 dhe 2, duhet të sigurojë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave, në përputhje të plotë me dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 21

**Shkëmbimi i informacionit shtesë ndërmjet autoriteteve doganore dhe operatorëve ekonomikë**

1. Autoritetet doganore dhe operatorët ekonomikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të shkëmbejnë çdo informacion, i cili nuk kërkohet në mënyrë specifike nga legjislacioni doganor, veçanërisht për qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë në identifikimin e riskut dhe masat kundërvepruese ndaj tij. Ky shkëmbim bëhet sipas një marrëveshjeje me shkrim dhe mund të përfshijë aksesin e autoriteteve doganore në sistemet kompjuterike të operatorëve ekonomikë.

2. Çdo informacion i dhënë nga njëra palë tek tjetra, gjatë bashkëpunimit të përmendur në pikën 1, është konfidencial, përveçse kur të dyja palët bien dakord ndryshe.

Neni 22
**Dhënia e informacionit nga autoritetet doganore**

1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e autoriteteve doganore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, për sa kohë nuk është përcaktuar ndryshe në këtë Kod.

2. Çdo person mund të kërkojë informacion lidhur me rregullat dhe zbatimin e procedurave doganore nga autoritetet doganore. Një kërkesë e tillë mund të refuzohet nëse nuk ka lidhje me një aktivitet që ka të bëjë me tregtinë ndërkombëtare të mallrave dhe që do të kryhet realisht.

3. Autoritetet doganore mbajnë kontakte të rregullta me operatorët ekonomikë dhe autoritetet e tjera, të përfshira në tregtinë ndërkombëtare të mallrave. Ato promovojnë transparencën, duke bërë lirisht të disponueshëm pa pagesë dhe përmes internetit, legjislacionin doganor, aktet nënligjore dhe formularët e aplikimit.

Neni 23
**Dhënia e informacionit autoriteteve doganore**

1. Çdo person, i përfshirë direkt apo indirekt në përmbushjen e formaliteteve doganore ose në kontrollet doganore, duhet, me kërkesë të autoriteteve doganore dhe brenda afateve kohore të caktuara, t'u japë këtyre autoriteteve të gjitha dokumentet dhe informacionin e kërkuar në një formë të përshtatshme dhe të gjithë asistencën e nevojshme për përmbushjen e këtyre formaliteteve ose kontrolleve.

2. Depozitimi i një deklarate doganore, i një deklarate të magazinimit të përkohshëm, i një deklarate përmbledhëse të hyrjes, deklarate përmbledhëse të daljes, deklarate rieksporti ose njoftimi rieksporti nga një person drejt autoriteteve doganore ose dorëzimi i një aplikimi për një autorizim apo çdo vendim tjetër e bën këtë person përgjegjës për:

a) saktësinë dhe tërësinë e informacionit të dhënë në deklaratë, në njoftim ose aplikim;

b) autenticitetin, vërtetësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti që shoqëron deklaratën, njoftimin ose aplikimin;

c) kur është e zbatueshme, përputhjen me të gjitha detyrimet që kanë lidhje me vendosjen e mallrave në fjalë nën një regjim doganor apo me kryerjen e operacioneve të autorizuara.

Pika 1 zbatohet gjithashtu edhe për marrjen e çdo informacioni në çfarëdo forme tjetër që është kërkuar nga/ose dhënë tek autoritetet doganore.

Në rastet kur deklarata ose njoftimi është depozituar, aplikimi është paraqitur ose informacioni është siguruar nga një përfaqësues doganor i personit në fjalë, siç përcaktohet në nenin 24, përfaqësuesi doganor gjithashtu është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 1.

SEKSIONI 2
PËRFAQËSIMI NË DOGANË

Neni 24
**Përfaqësuesi doganor**

1. Çdo person mund të caktojë një përfaqësues doganor.

Një përfaqësim i tillë mund të jetë ose direkt, në rastin kur përfaqësuesi doganor vepron në emër e për llogari të një personi tjetër, ose i tërthortë, kur përfaqësuesi doganor vepron në emër të tij, por për llogari të një personi tjetër.

2. Një përfaqësues doganor duhet të jetë i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen kushtet nën të cilat një përfaqësues doganor mund të ofrojë shërbime në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25
**E drejta e përfaqësimit**

1. Kur bëhen veprime me autoritetet doganore, një përfaqësues doganor duhet të deklarojë që ai po vepron për llogari të personit që përfaqëson dhe të specifikojë nëse përfaqësimi është i drejtpërdrejtë apo i tërthortë.

Një person, i cili nuk deklaron që po vepron si një përfaqësues doganor ose kur deklaron që po vepron si një përfaqësues doganor, pa aktin ligjor të përfaqësimit për të vepruar si i tillë, konsiderohet sikur po vepron në emër dhe për llogari të tij.

2. Autoritetet doganore mund t'i kërkojnë çdo personi, i cili deklaron që po vepron si një përfaqësues doganor, prova që atij i është lëshuar akti ligjor i përfaqësimit nga i përfaqësuari.

3. Në raste të veçanta autoritetet doganore mund të mos kërkojnë paraqitjen e këtyre provave.

4. Autoritetet doganore nuk do t'i kërkojnë një personi që vepron si përfaqësues doganor e që kryen rregullisht veprime ose formalitete për të siguruar për çdo rast prova të së drejtës së përfaqësimit, duke prezumuar që ky person është në gjendje të sigurojë të tilla prova me kërkesë të autoriteteve doganore.

Neni 26
**Aktet nënligjore**

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet kur nga autoritetet doganore nuk kërkohet akti ligjor i përfaqësimit, i referuar në pikën 2, të nenit 25;

b) rregullat procedurale për zbatimin e pikës 3, të nenit 25.

## SEKSIONI 3
## VENDIMET E FAVORSHME NË LIDHJE ME ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT DOGANOR

### Neni 27
### Vendimet e favorshme që merren mbi baza aplikimi

1. Kur një person aplikon për marrjen e një vendimi në favor të tij, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, ky person duhet të vërë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar nga autoritetet doganore kompetente, në mënyrë që ato të jenë në gjendje për të marrë këtë vendim.

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin doganor, një vendim i tillë gjithashtu mund të kërkohet nga/dhe të merret në lidhje me disa persona.

Përveçse kur parashikohet ndryshe, autoritet doganor kompetent është ai i vendit ku aplikuesi mban kontabilitetin kryesor për qëllime doganore dhe ku ai kryen të paktën një pjesë të aktivitetit që përfshihet në vendim.

2. Autoritetet doganore, maksimumi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit për një vendim të favorshëm, verifikojnë nëse janë përmbushur kushtet për pranimin e këtij aplikimi.

Kur autoritetet doganore arrijnë në përfundimin se aplikimi përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që mundëson marrjen e një vendimi prej tyre, ato ia komunikojnë aplikuesit pranimin e aplikimit brenda afatit të sipërpërmendur.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, një vendim, siç përmendet në pikën 1, merret dhe i njoftohet pa vonesë aplikuesit, maksimumi brenda 120 ditëve nga data e pranimit të aplikimit.

Kur autoritetet doganore nuk janë në gjendje të përmbushin afatin kohor për marrjen e vendimit, ato duhet ta informojnë aplikuesin për këtë fakt para mbarimit të këtij afati, duke deklaruar arsyet dhe duke përcaktuar afatin tjetër kohor, të cilin ato e konsiderojnë të nevojshëm për të marrë një vendim. Përveçse kur është përcaktuar ndryshe, afati shtesë i përcaktuar nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë.

Pa rënë ndesh me paragrafin e dytë të kësaj pike, autoritetet doganore mund ta zgjatin afatin kohor për marrjen e një vendimi, siç përcaktohet në legjislacionin doganor, kur aplikuesi kërkon një zgjatje të afatit, me qëllim që të kryejë rregullimet e duhura për të siguruar plotësimin e kushteve e të kritereve. Këto përmirësime dhe afati i mëtejshëm, i nevojshëm për plotësimin e kushteve dhe kritereve, u komunikohet autoriteteve doganore, të cilat do të marrin vendim për zgjatjen e afatit.

4. Përveçse kur përcaktohet ndryshe në vendim ose në legjislacionin doganor, vendimi i favorshëm hyn në fuqi në datën, në të cilën aplikuesi e merr vendimin ose konsiderohet sikur ta ketë marrë atë. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2, të nenit 46, vendimet e miratuara zbatohen nga autoritetet doganore që nga kjo datë.

5. Përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin doganor, vendimi është i vlefshëm pa afat kohor.

6. Para se të refuzojnë marrjen e një vendimi të favorshëm për aplikuesin, autoritetet doganore i komunikojnë atij arsyet, mbi të cilat ato do të mbështetin vendimin e tyre, duke i dhënë edhe mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tij brenda një afati të caktuar, që nga data kur është bërë komunikimi ose që konsiderohet si i bërë. Pas mbarimit të këtij afati kohor, aplikuesi njoftohet për vendimin.

Paragrafi i mësipërm nuk aplikohet në rastet e mëposhtme:

a) kur ka lidhje me një vendim të referuar në pikën 1, të nenit 36;

b) në rast të refuzimit të përfitimit nga një kuotë tarifore, kur është arritur volumi specifik i kuotës tarifore, përcaktuar në paragrafin e parë, të pikës 4, të nenit 56;

c) kur natyra ose niveli i një kërcënimi për sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë e të qytetarëve të saj, shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve e kërkon këtë;

ç) kur vendimi synon të sigurojë zbatimin e një vendimi tjetër, për të cilin është zbatuar paragrafi i parë, i kësaj pike;

d) kur cenon hetime të filluara për qëllime të luftës kundër mashtrimit;

dh) në raste të tjera të veçanta.

7. Kur refuzohet marrja e një vendimi të favorshëm për aplikuesin duhet të jepen arsyet mbi të cilat është bazuar, si dhe të vihet në dukje edhe e drejta për ankim, e parashikuar në nenin 45.

### Neni 28
### Mbikëqyrja e vendimeve të favorshme të marra në bazë të aplikimeve

1. Personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga ky vendim.

2. Pasi vendimi është marrë, personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, informon autoritetet doganore pa vonesë për çdo faktor të krijuar, i cili mund të ndikojë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e vendimit.

3. Pa cenuar dispozitat e përcaktuara në fusha të tjera, që specifikojnë rastet, në të cilat vendimet janë të pavlefshme ose anulohen, autoritetet doganore, të cilat kanë marrë një vendim të favorshëm, mund në çdo kohë ta anulojnë, ta ndryshojnë ose ta revokojnë atë kur ai nuk është në përputhje me legjislacionin doganor.

4. Në raste të veçanta autoritetet doganore mund:

a) të rivlerësojnë një vendim të favorshëm;

b) të pezullojnë vendimin, nëse nuk është rasti për ta anuluar, revokuar ose ndryshuar atë.

5. Autoritetet doganore mbikëqyrin kushtet dhe kriteret që duhen përmbushur nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi i favorshëm. Ato gjithashtu mbikëqyrin përputhshmërinë me detyrimet që rrjedhin prej vendimit. Kur personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, është regjistruar (themeluar aktiviteti) prej një periudhe për më pak se 3 vjet, autoritetet doganore duhet ta mbikëqyrin nga afër atë gjatë gjithë vitit të parë pas marrjes së vendimit.

Neni 29
**Aktet nënligjore**

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) përjashtimet e paragrafit të tretë, të pikës 1, të nenit 27;

b) kushtet për pranimin e aplikimit, referuar pikës 2, të nenit 27;

c) afatet kohore për të marrë një vendim të caktuar, duke përfshirë zgjatjet e mundshme të këtij afati, në përputhje me pikën 3, të nenit 27;

ç) rastet e referuara në pikën 4, të nenit 27, kur vendimi është i zbatueshëm nga një datë, që është e ndryshme nga data, në të cilën aplikuesi ka marrë ose konsiderohet se ka marrë vendimin;

d) rastet e referuara në pikën 5, të nenit 27, kur vlefshmëria e një vendimi është e kufizuar në kohë;

dh) afati i përmendur në paragrafin e parë, të pikës 6, të nenit 27;

e) rastet e veçanta të përmendura në shkronjën "dh", të paragrafit të dytë, të pikës 6, të nenit 27, kur aplikuesit nuk i është dhënë mundësia të shprehë pikëpamjen e tij;

ë) rastet dhe rregullat për rivlerësimin dhe pezullimin e vendimeve, në përputhje me pikën 4, të nenit 28;

f) rregullat dhe procedurat për dorëzimin dhe pranimin e aplikimit për një vendim, sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 27;

g) rregullat dhe procedurat për marrjen e vendimit, sipas nenit 27;

gj) rregullat dhe procedurat për mbikëqyrjen e vendimit, në përputhje me pikën 5, të nenit 28.

Neni 30
**Shtrirja e vlefshmërisë së vendimeve të favorshme**

Vendimet e favorshme, lidhur me zbatimin e legjislacionit doganor, janë të vlefshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur efekti i tyre është i kufizuar për një ose disa zyra doganore.

Neni 31
**Anulimi i vendimeve të favorshme**

1. Autoritetet doganore anulojnë një vendim në favor të personit, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në qoftë se plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) vendimi është marrë bazuar në informacion të pasaktë ose të paplotë;

b) personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, ishte në dijeni ose objektivisht duhej të ishte në dijeni që informacioni i dhënë ishte i pasaktë ose i paplotë.

2. Personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, duhet të njoftohet për anulimin e tij.

3. Anulimi i shtrin efektet që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit fillestar, përveçse kur, në përputhje me legjislacionin doganor, në vendim specifikohet ndryshe.

Neni 32
**Revokimi dhe ndryshimi i vendimeve të favorshme**

1. Përveç rasteve të përcaktuara në nenin 31, një vendim në favor të aplikuesit revokohet ose ndryshohet:

a) edhe kur një apo më shumë nga kushtet, në bazë të të cilave është marrë një vendim, nuk ishin përmbushur ose nuk përmbushen më; ose

b) me aplikim nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe, një vendim i marrë në favor të disa personave mund t'i revokohet vetëm personit, i cili nuk plotëson një detyrim të ngarkuar, sipas atij vendimi.

3. Personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, duhet të njoftohet për revokimin ose ndryshimin e tij, si dhe të drejtën e ankimit.

4. Pika 4, e nenit 27, zbatohet edhe në rastet e revokimit ose ndryshimit të vendimit.

Megjithatë, në raste të veçanta, kur e kërkojnë interesat legjitimë të personit, ndaj të cilit është dhënë vendimi, autoritetet doganore mund ta shtyjnë datën e shtrirjes së efekteve të revokimit ose ndryshimit deri në një vit. Kjo datë duhet të përcaktohet në vendimin e revokimit apo të ndryshimit.

Neni 33
**Vendimet e marra pa një aplikim**

Në rastet e parashikuara në pikat 4, 5, 6 dhe 7, të nenit 27, pika 3, e nenit 28, dhe nenet 30, 31 dhe 32, autoritetet doganore mund të marrin vendim edhe në mungesë të një aplikimi nga personi i interesuar.

Neni 34

**Kufizime për vendimet që kanë të bëjnë me mallrat e vendosura nën një regjim doganor ose në magazinim të përkohshëm**

Me përjashtim të rastit kur personi i interesuar e kërkon, revokimi, ndryshimi apo pezullimi i një vendimi të favorshëm nuk i shtrin efektet mbi mallrat, të cilat, në momentin kur revokimi, ndryshimi apo pezullimi hyjnë në fuqi, kanë qenë dhe janë të vendosura në një regjim doganor ose në magazinim doganor dhe që kanë lidhje me vendimin e revokimit, ndryshimit apo pezullimit.

Neni 35

**Aktet nënligjore**

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 32, kur një vendim i favorshëm, i marrë për disa persona, mund t'u revokohet gjithashtu edhe personave të tjerë, të ndryshëm nga personi, i cili nuk ka plotësuar një detyrim të ngarkuar, sipas atij vendimi;

b) rastet përjashtimore kur autoritetet doganore shtyjnë datën, në të cilën revokimi ose ndryshimi hyn në fuqi, në përputhje me paragrafin e dytë, të pikës 4, të nenit 32;

c) rregullat procedurale për anulimin, revokimin ose ndryshimin e vendimeve të favorshme.

Neni 36

**Vendime për informacionin detyrues**

1. Autoritetet doganore, në bazë të aplikimeve, marrin vendime për informacionin detyrues tarifor ("vendime IDT") ose vendime për informacionin detyrues të origjinës ("vendime IDO").

Një aplikim i tillë nuk pranohet në njërën prej rrethanave të mëposhtme:

a) kur aplikimi bëhet ose është bërë pranë autoriteteve doganore nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, ose në interes të tij, për sa u përket të njëjtave mallra dhe për "vendimet IDO", sipas të njëjtave rrethana, që përcaktojnë marrjen e origjinës;

b) kur aplikimi nuk është i lidhur me ndonjë përdorim të parashikuar në "vendimin IDT" apo "vendimin IDO" ose me ndonjë përdorim të parashikuar të një regjimi doganor.

2."Vendimet IDT ose IDO" janë detyruese vetëm për sa i përket klasifikimit tarifor ose përcaktimit të origjinës së mallrave për:

a) autoritetet doganore kundrejt personit, ndaj të cilit është dhënë vendimi, vetëm për sa u përket mallrave, për të cilat formalitetet doganore janë përfunduar, pas datës së hyrjes në fuqi të vendimit;

b) personin, ndaj të cilit është dhënë vendimi, kundrejt autoriteteve doganore, nga data kur ka marrë ose konsiderohet të ketë marrë njoftimin e vendimit.

3."Vendimet IDT ose IDO" janë të vlefshme për një afat prej tre vjetësh nga data në të cilën vendimi hyn në fuqi.

4. Për zbatimin e një "vendimi IDT ose IDO", në kontekstin e një regjimi doganor të veçantë, personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, duhet të jetë i aftë të provojë që:

a) në rastin e një "vendimi IDT", mallrat e deklaruara korrespondojnë në çdo aspekt me ato të përshkruara në vendim;

b) në rastin e një "vendimi IDO", mallrat në fjalë dhe rrethanat që përcaktojnë marrjen e origjinës korrespondojnë në çdo aspekt me mallrat dhe rrethanat e përshkruara në vendim.

Neni 37

**Administrimi i vendimeve të lidhura me informacionin detyrues**

1. Një "vendim IDT" humb vlefshmërinë përpara përfundimit të periudhës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 36, kur ai nuk është më në përputhje me ligjin, si rezultat i njërës prej përcaktimeve të mëposhtme:

a) ndryshimit të nomenklaturave, të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 56;

b) ndryshimit të masave, të përcaktuara në pikën 3, të nenit 57, me efekt që nga data e zbatimit të këtyre ndryshimeve apo masave.

2. Një "vendim IDO" humb vlefshmërinë përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 3, të nenit 36, në një nga rastet e mëposhtme:

a) kur një ligj i miratuar ose një marrëveshje e nënshkruar ka hyrë në fuqi dhe ky vendim nuk është më në përputhje me ligjin, me efekt që nga data e zbatimit të ligjit apo marrëveshjes;

b) kur nuk është më në përputhje me marrëveshjen për rregullat e origjinës, të vendosura nga Organizata Botërore e Tregtisë, ose me shënimet shpjeguese apo me një opinion për origjinën, të miratuar për interpretimin e kësaj marrëveshjeje, me efekt nga data e njoftimit të autoriteteve doganore nga sekretariati i OBT-së në Shqipëri.

3. Humbja e vlefshmërisë së një "vendimi IDT ose IDO" nuk ka efekt prapaveprues.

4. Duke anashkaluar pikën 3, të nenit 28, dhe nenin 31, "vendimet IDT ose IDO" anulohen kur ato janë bazuar në informacion të pasaktë ose të paplotë, të dhënë nga aplikuesi.

5. "Vendimet IDT ose IDO" revokohen në përputhje me pikën 3, të nenit 28, dhe me nenin 32.

Megjithatë këto vendime nuk revokohen me aplikim nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi.

6. "Vendimet IDT ose IDO" nuk mund të ndryshohen.

7. Autoritetet doganore revokojnë “vendimet IDT”:

a) kur ato nuk janë më në përputhje me interpretimin e ndonjërës prej nomenklaturave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 56;

b) në raste të tjera specifike.

8. “Vendimet IDO” revokohen:

a) kur nuk janë më në përputhje me legjislacionin që rregullon fushën specifike, për shkak të ndryshimit të këtij legjislacioni;

b) në raste të tjera specifike.

9. Kur zbatohet shkronja “b”, e pikës 1, ose pikat 2, 7 ose 8, të këtij neni, një “vendim IDT ose IDO” mund të vazhdojë të përdoret në zbatim të kontratave detyruese, të bazuara në atë vendim dhe që janë nënshkruar përpara humbjes së vlefshmërisë apo revokimit të vendimit. Shtyrja e përdorimit të një “vendimi IDO” nuk zbatohet kur vendimi është marrë për mallra që eksportohen.

Shtyrja e përdorimit, e përcaktuar sipas paragrafit të mësipërm, nuk duhet të jetë më e gjatë se 6 muaj nga data në të cilën një “vendim IDT ose IDO” humb vlefshmërinë ose revokohet.

Me qëllim përfitimin nga shtyrja e përdorimit të një “vendimi IDT ose IDO”, personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, depoziton një aplikim pranë autoriteteve doganore që e kanë marrë atë vendim, brenda 30 ditëve nga data që ai ka humbur vlefshmërinë ose është revokuar.

Neni 38

**Vendime për informacione detyruese e që kanë lidhje me faktorë të tjerë**

Në raste specifike, autoritetet doganore, në bazë të aplikimit, marrin vendime për informacione detyruese e që kanë lidhje me faktorë të tjerë, të përcaktuar në titullin II të këtij Kodi, në bazë të të cilave janë aplikuar detyrimet e importit ose të eksportit dhe masa të tjera të karakterit tregtar.

Neni 39

**Aktet nënligjore**

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet specifike, të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 7, të nenit 37, dhe shkronjës “b”, të pikës 8, të nenit 37, kur “vendimet IDT dhe IDO” revokohen;

b) rastet e përcaktuara në nenin 38, kur vendimet për informacione detyruese janë marrë duke pasur lidhje me faktorë të tjerë, në bazë të të cilëve janë aplikuar detyrimet e importit ose të eksportit dhe masa të tjera të karakterit tregtar;

c) rregullat procedurale për përdorimin e një “vendimi IDT ose IDO”, pasi ai humb vlefshmërinë apo revokohet, në përputhje me pikën 9, të nenit 37;

ç) rregullat procedurale për përdorimin e vendimeve të përcaktuara në nenin 38, dhe të vendosura në përputhje me shkronjën “b”, të këtij neni, pasi ato humbasin vlefshmërinë.

SEKSIONI 4
OPERATORI EKONOMIK I AUTORIZUAR

Neni 40

**Aplikimi dhe autorizimi**

1. Një operator ekonomik, i cili është i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe përmbush kriteret e vendosura në nenin 41, mund të aplikojë për statusin e operatorit ekonomik të autorizuar.

Nëse vlerësohet e nevojshme, autoritetet doganore mund të konsultohen me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit sa i takon verifikimit të plotësimit të kritereve të përcaktuara në nenin 41. Vendimi për dhënien e statusit të operatorit ekonomik të autorizuar është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme.

2. Statusi i operatorit ekonomik të autorizuar ka të bëjë me llojet e autorizimeve të mëposhtme:

a) atë të një operatori ekonomik të autorizuar për “thjeshtësime doganore”, i cili i mundëson mbajtësit të tij përfitime për disa thjeshtësime, në përputhje me legjislacionin doganor; ose

b) atë të një operatori ekonomik të autorizuar për “sigurinë dhe mbrojtjen”, i cili i mundëson mbajtësit të tij lehtësi që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen.

3. Të dyja llojet e autorizimeve, të përcaktuara në pikën 2, mund të mbahen njëkohësisht.

4. Autoritetet doganore, në bazë të njohjes të statusit të operatorit ekonomik të autorizuar për thjeshtësi doganore dhe me kusht që të jenë plotësuar kërkesat që lidhen me një lloj specifik të thjeshtësimit, autorizojnë operatorin për të përfituar nga ky thjeshtësim. Autoritetet doganore nuk rishqyrtojnë ato kritere, të cilat janë shqyrtuar një herë kur është dhënë statusi i operatorit ekonomik të autorizuar.

5. Operatori ekonomik i autorizuar, i përcaktuar në pikën 2, gëzon trajtim më të favorshëm se operatorët e tjerë ekonomikë përsa u përket kontrolleve doganore, në përputhje me llojin e autorizimit të dhënë, duke përfshirë më pak kontrolle fizike dhe dokumentare.

Neni 41

**Dhënia e statusit**

Aplikuesi, për t’iu dhënë statusi i operatorit ekonomik të autorizuar, duhet të plotësojë këto kritere:

a) të mos ketë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të legjislacionit doganor dhe tatimor;

b) të mos jetë i proceduar penalisht për vepra penale që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikuesit;

c) të demonstrojë një nivel të lartë kontrolli të veprimeve të tij dhe të lëvizjes së mallrave me anë të një sistemi që menaxhon regjistrimet tregtare dhe, kur është

me vend, edhe regjistrimet e transportit, i cili lejon kryerjen e kontrolleve të duhura doganore;

ç) të ketë aftësi paguese që do të kërkohen për të provuar nëse aplikuesi ka gjendje të mirë financiare, e cila i lejon atij të përmbushë angazhimet që rrjedhin e lidhen me karakteristikat e llojit të aktivitetit në fjalë;

d) për sa i takon autorizimit të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 40, të ketë standardet praktike të kompetencave ose kualifikimeve profesionale që lidhen direkt me aktivitetin e kryer;

dh) për sa i takon autorizimit, të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 40, të ketë standardet e duhura të sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat konsiderohen të plotësuara kur aplikuesi tregon se ai siguron masat e duhura për zbatimin e sigurisë dhe mbrojtjes së zinxhirit tregtar ndërkombëtar, përfshirë fushat e integritetit fizik dhe kontrollit të aksesit, proceset logjistike dhe trajtimet për lloje të veçanta mallrash, personel dhe identifikimin e partnerëve të tij të biznesit.

Neni 42
**Aktet nënligjore**

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) thjeshtësitë e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 40;

b) lehtësitë e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 40;

c) trajtimet më të favorshme, të përcaktuara në pikën 5, të nenit 40;

ç) modalitetet për aplikimin e kritereve, të përcaktuara në nenin 41.

SEKSIONI 5
SANKSIONET

Neni 43
**Zbatimi i sanksioneve**

Autoritetet doganore në Republikën e Shqipërisë vendosin sanksionet për shkeljet lidhur me vendimet e favorshme, në përputhje me legjislacionin doganor. Sanksione të tilla duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese. Sanksionet zbatohen pavarësisht nga aplikimi i mundshëm i revokimit, anulimit apo ndryshimit të një vendimi.

SEKSIONI 6
ANKIMET

Neni 44
**Vendimet e marra nga një autoritet gjyqësor**

Nenet 45 dhe 46 nuk zbatohen për ankime të depozituara për qëllime të anulimit, revokimit ose ndryshimit të një vendimi, që ka lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor dhe që është marrë nga një autoritet gjyqësor ose nga organet doganore kur veprojnë si autoritete gjyqësore.

Neni 45
**E drejta e ankimit**

1. Çdo person ka të drejtë të ankimojë vendimet e marra nga autoritetet doganore për refuzimin e një aplikimi apo vendimin për anulimin ose revokimin e një vendimi të favorshëm, i cili ka të bëjë me të drejtpërdrejt dhe individualisht.

Çdo person mund të ushtrojë të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në rastet kur ka aplikuar pranë autoriteteve doganore për një vendim të favorshëm dhe nuk është respektuar afati i përcaktuar në pikën 3, të nenit 27.

2. E drejta e ankimit mund të ushtrohet:

a) duke paraqitur ankim përpara autoriteteve doganore ose një strukture specifike, të krijuar për këtë qëllim;

b) pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit të ankimit administrativ, duke iu drejtuar me padi gjykatës kompetente, sipas dispozitave në fuqi.

3. Personi i interesuar mund të ankohet, sipas paragrafit të parë të pikës 1, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vendos brenda 30 ditëve për pranimin ose jo të ankimit.

4. Personi i interesuar mund të ankohet sipas paragrafit të dytë, të pikës 1, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, brenda 15 ditëve nga data e mbarimit të këtij afati. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vendos brenda 30 ditëve për pranimin ose jo të ankimit.

5. Në rast se anulimi apo revokimi i një vendimi të favorshëm shoqërohet edhe me sanksione, të përcaktuara në titullin IX të këtij Kodi, procedura e ankimit kryhet në përputhje me nenet 281 dhe 282.

Neni 46
**Pezullimi i zbatimit**

1. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit të ankimuar.

2. Megjithatë, autoritetet doganore pezullojnë zbatimin e një vendimi të ankimuar, tërësisht ose pjesërisht, kur ato kanë arsye të besojnë që vendimi i ankimuar është i papajtueshëm me legjislacionin doganor ose sjell një dëm të pariparueshëm për personin e interesuar.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2, kur vendimi i ankimuar shkakton detyrime importi ose eksporti për t'u paguar, pezullimi i këtij vendimi duhet të kushtëzohet me dhënien/depozitimin e një garancie, përveçse kur, duke u mbështetur në një vlerësim të dokumenteve, vërtetohet se kjo garanci mund t'i

shkaktojë debitorit vështirësi serioze ekonomike ose sociale.

SEKSIONI 7
KONTROLLI I MALLRAVE

Neni 47
**Menaxhimi i riskut dhe kontrollet doganore**

1. Autoritetet doganore mund të kryejnë të gjitha kontrollet doganore që i vlerësojnë të nevojshme.

Kontrollet doganore mund të konsistojnë në veçanti në verifikimin e mallrave, marrjen e mostrave, verifikimin e informacionit të dhënë në një deklaratë ose njoftim nëse është i vërtetë dhe i plotë, si dhe ekzistencën e tij, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e dokumenteve, shqyrtimin e llogarive të operatorëve ekonomikë dhe regjistrime të tjera, inspektimin e mjeteve të transportit, inspektimin e bagazheve e të mallrave të tjera që sjellin ose mbajnë personat dhe kryerjen e hetimeve zyrtare ose veprime të tjera të ngjashme.

2. Kontrollet doganore, përveç kontrolleve të rastësishme, mbështeten kryesisht në analizën e riskut, duke përdorur teknika elektronike të përpunimit të të dhënave, me qëllim identifikimin e vlerësimin e riskut dhe zhvillimin e masave kundërvepruese të nevojshme, në bazë të kritereve të hartuara në nivel kombëtar dhe, aty ku janë të disponueshme, në nivel ndërkombëtar.

3. Kontrollet doganore kryhen brenda një kornize të përbashkët të menaxhimit të riskut, duke u bazuar në shkëmbimin e informacionit për risqet dhe rezultatet e analizave të riskut ndërmjet administratave doganore homologe, duke vendosur kritere dhe standarde risku të përbashkëta, duke marrë masa kontrolli e duke përcaktuar fusha prioritare kontrolli.

Kontrollet e mbështetura në këto informacione dhe kritere do të kryhen pa cenuar kontrollet e tjera të kryera në përputhje me pikën 1 ose me dispozitat e tjera në fuqi.

4. Autoritetet doganore përdorin menaxhimin e riskut për të diferencuar nivelet e riskut, që lidhen me mallrat që janë objekt i kontrollit ose i mbikëqyrjes doganore dhe për të vendosur kryerjen ose jo të kontrolleve specifike mbi këto mallra. Në rastin e një vendimi për kontroll përcaktohet edhe vendi ku kryhet kontrolli.

Menaxhimi i riskut përfshin veprime të tilla, si mbledhja e të dhënave dhe informacioneve, analizimi dhe vlerësimi i riskut, evidentimi dhe ndërmarrja e veprimeve, monitorimi i vazhdueshëm dhe rishikimi i këtij procesi dhe i rezultateve të tij, bazuar në burime dhe strategji kombëtare dhe ndërkombëtare.

5. Autoritetet doganore shkëmbejnë informacione për risqet dhe rezultatet e analizave të riskut kur:

a) këto autoritete vlerësojnë se risqet janë të larta dhe kërkojnë kontroll doganor dhe kur rezultatet e kontrollit tregojnë se ngjarja, e cila ishte vlerësuar me risk, ka ndodhur; ose

b) rezultatet e kontrollit tregojnë që ngjarja, e cila ishte vlerësuar me risk, nuk ka ndodhur, por autoritetet doganore vlerësojnë se risku mund të jetë i lartë për një administratë tjetër doganore.

6. Për përcaktimin e kritereve dhe standardeve të përbashkëta në fushën e riskut, si dhe të masave e fushave të kontrolleve prioritare, të parashikuara në pikën 3, mbahen parasysh të gjitha elementet si më poshtë:

a) proporcionaliteti i riskut;

b) urgjenca e nevojës së zbatimit të kontrolleve;

c) ndikimi i mundshëm mbi shkëmbimet tregtare dhe mbi burimet e nevojshme për këto kontrolle.

7. Kriteret dhe standardet e përbashkëta, të përcaktuara në pikën 3, përfshijnë të gjitha elementet e mëposhtme:

a) një përshkrim të risqeve;

b) faktorët ose indikatorët e riskut që duhet të përdoren për të përzgjedhur mallrat ose operatorët ekonomikë për kontroll doganor;

c) llojin e kontrolleve doganore që duhet të ndërmerren nga autoritetet doganore;

ç) kohëzgjatjen e kryerjes së kontrolleve doganore, të përcaktuara në shkronjën "c".

8. Fushat e kontrolleve prioritare mbulojnë regjime doganore të caktuara, lloje mallrash, itinerare lëvizjesh, mënyra transporti ose operatorë ekonomikë, të cilët, gjatë një periudhe të caktuar, janë objekt i analizës së riskut dhe i kontrolleve doganore të niveleve më të larta, pa rënë ndesh me kontrollet e zakonshme që kryhen nga autoritetet doganore.

Neni 48
**Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve**

1. Kur për të njëjtat mallra, përveç kontrolleve doganore, kryhen kontrolle edhe nga autoritete të tjera kompetente, autoritetet doganore, në bashkëpunim të ngushtë me këto të fundit, kur është e mundur, përpiqen t'i kryejnë këto kontrolle në të njëjtin vend e kohë me kontrollin doganor (one-stop-shop). Autoritetet doganore kanë rolin koordinues në këto kontrolle.

2. Me qëllim minimizimin e riskut dhe luftën kundër mashtrimit, në kuadër të kontrolleve të përmendura në këtë seksion, autoritetet doganore dhe institucionet e tjera përgjegjëse, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi mund të shkëmbejnë ndërmjet tyre të dhënat e marra që lidhen me:

a) hyrjen, daljen, transitin, lëvizjen, magazinimin, përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use) të mallrave, përfshirë trafikun postar, që lëvizin ndërmjet territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve ose territoreve që ndodhen jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) praninë dhe qarkullimin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave joshqiptare dhe të mallrave të vendosura në regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use);

c) rezultatet e kontrolleve të kryera.

3. Me qëllim që të sigurohet zbatimi korrekt i legjislacionit doganor, autoritetet doganore bashkëpunojnë me organizma publikë ose privatë, shqiptarë ose të huaj. Mënyrat dhe format e bashkëpunimit e të shkëmbimit të informacionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij Kodi, në akte të tjera ligjore dhe nënligjore apo në marrëveshje bashkëpunimi.

4. Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre.

Neni 49

**Kontrolli pas çlirimit të mallrave**

Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave, mund të verifikojnë saktësinë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes, deklaratën e rieksportit ose në njoftimin rieksportit, si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti shoqërues.

Gjithashtu, ato mund të verifikojnë kontabilitetin e deklaruesit dhe regjistrime të tjera që lidhen me veprimet që janë kryer mbi mallrat në fjalë ose për veprimet tregtare paraprake ose veprimet në vijim që përfshijnë këto mallra. Autoritetet doganore gjithashtu mund të verifikojnë këto mallra dhe/ose të marrin mostra, nëse ekziston akoma një mundësi e tillë.

Kontrolle të tilla mund të kryhen në ambientet e mbajtësit të mallrave ose përfaqësuesit të tij, të çdo personi tjetër të përfshirë direkt apo indirekt në veprimet e sipërpërmendura, në kuadër të aktivitetit të tij të biznesit, ose të çdo personi tjetër që i zotëron këto dokumente dhe të dhëna për qëllime të aktivitetit të biznesit.

Neni 50

**Transporti ajror dhe detar brenda Republikës së Shqipërisë**

1. Kontrollet ose formalitetet doganore zbatohen për bagazhet e dorës dhe bagazhet e hambarit të personave që kryejnë një udhëtim ajror ose detar brenda Republikës së Shqipërisë, vetëm kur legjislacioni doganor i parashikon këto kontrolle ose formalitete.

2. Pika 1 zbatohet pa cenuar asnjë prej rasteve të mëposhtme:

a) kontrollet e sigurisë dhe mbrojtjes;

b) kontrollet lidhur me ndalimet ose kufizimet.

Neni 51

**Aktet nënligjore**

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave nxjerr aktet që përcaktojnë:

1. Masat që sigurojnë zbatimin uniform të kontrolleve doganore, përfshirë shkëmbimin e informacionit mbi riskun dhe mbi rezultatet e analizave të riskut, kriteret dhe standardet e përbashkëta të riskut, masat e kontrollit dhe fushat prioritare të kontrollit, të përcaktuara në pikën 3, të nenit 47;

2. Portet dhe aeroportet, të përcaktuara në nenin 50, ku zbatohen kontrollet dhe formalitetet doganore për:

a) bagazhet e dorës dhe bagazhet e hambarit të personave që:

i) udhëtojnë me një avion, i cili vjen nga një aeroport jashtë Republikës së Shqipërisë dhe që, pas një ndalese në një aeroport shqiptar, vazhdon fluturimin drejt një aeroporti tjetër shqiptar;

ii) udhëtojnë me një avion, i cili ndalon në një aeroport shqiptar përpara se të vazhdojë fluturimin drejt një aeroporti joshqiptar;

iii) përdorin një shërbim detar që ofrohet nga i njëjti mjet lundrimi dhe përfshin ndalesat e njëpasnjëshme që nisen nga, vazhdojnë ose përfundojnë në një port joshqiptar;

iv) janë në bordin e një mjeti për turizëm ose mjeti fluturimi biznesi;

b) bagazhet e dorës dhe bagazhet e hambarit që:

i) mbërrijnë në një aeroport shqiptar në bordin e një avioni që vjen nga një aeroport joshqiptar dhe transferohen në aeroportin shqiptar në një avion tjetër që vazhdon një fluturim kombëtar;

ii) ngarkohen në një avion në një aeroport shqiptar, duke vazhduar me një fluturim kombëtar, për t'u transferuar në një avion tjetër në një aeroport tjetër shqiptar me destinacion një aeroport joshqiptar.

SEKSIONI 8

RUAJTJA E DOKUMENTEVE DHE INFORMACIONEVE TË TJERA, PAGESAT DHE KOSTOT

Neni 52

**Ruajtja e dokumenteve dhe e informacioneve të tjera**

1. Për qëllime të kontrolleve doganore, personi i interesuar duhet të ruajë dokumentet dhe informacionin e përmendur në pikën 1, të nenit 23, për të paktën tre vjet, në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Në rastin e mallrave të çliruara për qarkullim të lirë në rrethana të tjera nga ato të përmendura në paragrafin

e tretë, të kësaj pike, ose mallrave të deklaruara për eksport, ky afat fillon nga data 31 dhjetor e vitit, në të cilin janë pranuar deklarimet doganore për çlirim për qarkullim të lirë ose për eksport.

Në rastin e mallrave të çliruara për qarkullim të lirë, të përjashtuara nga detyrimet apo me detyrime të reduktuara për arsye të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) të tyre, ky afat fillon nga data 31 dhjetor e vitit, në të cilin mallrat pushojnë së qeni nën mbikëqyrjen doganore.

Në rastin e mallrave të vendosura nën një regjim tjetër doganor ose të mallrave të vendosura në magazinim të përkohshëm, ky afat fillon nga data 31 dhjetor e vitit, në të cilin regjimi doganor në fjalë ka përfunduar ose magazinimi i përkohshëm ka mbaruar.

2. Pa cenuar pikën 4, të nenit 97, kur nga një kontroll doganor, në lidhje me një borxh doganor, rezulton se hedhja përkatëse në kontabilitet/llogari duhet të korrigjohet dhe personi në fjalë është njoftuar për këtë, dokumentet dhe informacioni ruhen për tre vjet përtej afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni.

Kur është depozituar një ankim ose kur ka filluar një proces gjyqësor, dokumentet dhe informacioni duhet të ruhen brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, ose derisa procedura e ankimit apo procesi gjyqësor të përfundojë, cilido që të jetë i fundit.

### Neni 53
### Pagesat dhe kostot

1. Autoritetet doganore nuk aplikojnë pagesa për kryerjen e kontrolleve doganore ose për procedura të tjera, që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit doganor, gjatë orarit zyrtar të punës së zyrave doganore të tyre.

2. Autoritetet doganore mund të aplikojnë pagesa ose të vjelin shpenzimet për kryerjen e shërbimeve të veçanta si më poshtë:

a) kur nga operatori ekonomik kërkohet prania e personelit doganor jashtë orarit zyrtar të punës ose në ambiente të tjera nga ato doganore;

b) në analizat ose raportet e ekspertëve për mallra dhe tarifa postare që paguhen për kthimin e këtyre mallrave tek aplikuesi, veçanërisht për vendimet e marra në përputhje me nenin 36 ose me dhënien e informacionit, në përputhje me pikën 1, të nenit 22;

c) për kontrollin ose marrjen e mostrave të mallrave për qëllime verifikimi ose për shkatërrimin e mallrave, kur përfshihen shpenzime jo të zakonshme, të tjera nga ato që kryhen nga personeli doganor;

ç) për masat e jashtëzakonshme të kontrollit, kur ato janë të nevojshme për shkak të natyrës së mallrave ose për shkak të një rreziku potencial.

3. Normat e pagesave, për zbatimin e pikës 2, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

## KREU IV
## KURSI I KËMBIMIT VALUTOR DHE AFATET KOHORE

### Neni 54
### Kursi i këmbimit valutor

1. Autoritetet doganore publikojnë dhe/ose vënë në dispozicion në internet kursin e këmbimit valutor të zbatueshëm, kur konvertimi i monedhës është i domosdoshëm për një nga arsyet e mëposhtme:

a) për shkak se elementet e përdorura për të përcaktuar vlerën doganore të mallrave janë shprehur në një monedhë tjetër, të ndryshme nga ajo e Republikës së Shqipërisë;

b) për shkak se vlera e monedhës kombëtare kërkohet në euro, me qëllim përcaktimin e klasifikimit tarifor të mallrave dhe shumës së detyrimit të importit e të eksportit, përfshirë pragjet e vlerës në Tarifën Doganore të Republikës së Shqipërisë.

2. Kursi i këmbimit valutor, për qëllim të zbatimit të pikës 1, të këtij neni, publikohet një herë në muaj, me përjashtim të përcaktimeve të pikës 5.

3. Kursi i këmbimit është i vlefshëm duke filluar nga data 6 e çdo muaji deri në datën 5 të muajit pasardhës.

4. Kursi i këmbimit që do të përdoret është kursi i këmbimit i shpallur nga Banka e Shqipërisë në ditën e fundit të punës së muajit paraardhës të periudhës së përmendur në pikën 3.

5. Kur kursi ditor i këmbimit, i shpallur nga Banka e Shqipërisë, është 5 për qind më i madh ose më i vogël se ai i vendosur në përputhje me pikën 4, për t'u përdorur në përputhje me pikën 3, ky i fundit zëvendësohet nga kursi ditor dhe hyn në fuqi në ditën e dytë pas shpalljes dhe përdoret si kurs këmbimi në zbatim të këtij neni për të gjithë periudhën e mbetur.

6. Kur këmbimi valutor është i nevojshëm për arsye të tjera nga ato të përmendura në pikën 1, kursi i këmbimit, që do të aplikohet brenda kuadrit të legjislacionit doganor, caktohet të paktën një herë në vit.

### Neni 55
### Periudhat, datat dhe afatet kohore

Përveçse kur parashikohet ndryshe, kur një periudhë kohore, datë ose afat kohor është përcaktuar në legjislacionin doganor, kjo periudhë kohore nuk mund të zgjatet apo të shkurtohet dhe data ose afati kohor nuk mund të shtyhet ose të afrohet në kohë.